

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

"AREN CONSTRUKSION" SH.P.K.

Ne Sarande **sot më date 03.09.2025**, ne respektim te kerkesave te Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2013 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne të nenshkruarit:

- Ardian Mullaj, i biri i Telin-it, e datelindjes 26 Mars 1970, lindur ne fshatin Vergo te rrethit Delvine dhe banues ne Sarande, lagjia nr. 4 rruga Sabri Preveza Godina nr.17, Bashkia Sarande, i kombesise dhe shtetësisë Shqiptare, mbajtese e ID. Nr. H00326104A, me date leshimi 17.05.2019.
- Arben Hamiti, i biri i Tefik-ut, e datelindjes 12 Qershor 1968, lindur ne Delvine dhe banues ne Sarande, lagjia nr.1, godina nr.8 Hyrja 6, Apartamenti 13, Bashkia Sarande, i kombesise dhe shtetësisë Shqiptare, mbajtese e ID. Nr. G80612175K, me date leshimi 28.10.2019.

shpallëm themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, si me poshtë vijon:

Neni 1

Shoqëria quhet "Aren Construksion" shpk (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar)

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqerise eshte ne Sarande Sarande, Lagjja nr.1,Rruga "Skenderbeu", godina nr.21 , Bashkia Sarande.

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, selia e shoqerise mund te transferohet ne nje rajon tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Gjithashtu, shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise apo dhe jashte tij.

Neni 3

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë se Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon qe prej datës se regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Biznesit.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Investitor në fushën e ndërtimit, per financimin e ndertimit te objekteve te ndryshme civile, industriale etj, dhe Agjensi imobiliare.

Shoqeria mund te ushtroje cdo veprimatri tjeter tregtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare").

Neni 5

Kjo shoqëri mund te ndryshoje emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortakë, te rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve te organeve drejtuese te kësaj shoqërie.

Neni 6

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është ne vleren e 100.000 leke, i perbere nga dy kuota ne zoterim të:

- ✓ Ardian Mullaj nje kuote prej 50,000 leke ose 50% te kapitalit themeltarte shoqerise,
- ✓ Arben Hamiti nje kuote prej 50,000 leke ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kapitali i shoqerise eshte nenshkruar plotesisht, dhe zoterohet nga ortakët Ardian Mullaj dhe Arben Hamiti, dhe perbehet nga dy kuota plotesisht të shlyeshme ne vlere.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë mund të rritet ne te ardhmen, nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes se kuotave te reja nga ortakë te rinj, vetëm me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve shoqerise, ku do të miratohet si rritja e kapitalit themeltar ashtu dhe hyrja e ortakëve të ri. Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te te gjithë ortakëve.

Neni 8

Ndryshimet ne kapitalin themeltar të shoqërisë mund te realizohet duke u bazuar ne dispozitat e veçanta qe parashikohen nga Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

Neni 9

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe përmban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne datën e regjistrimit ne Qenden Kombetare te Biznesit.

Neni 10

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit te derdhur prej tyre nuk

mund t'a tërheqin. Kjo mund të bëhet vetëm pasi të nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

Neni 11

Kuotat e çdo anëtarit përputhen me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Kuotat e tij anëtarit i shoqërisë mund t'ua ofrojnë të treta. Anëtarët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e kuotave përpara personave të treta jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjti me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të treta jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Organi administrativ jep përgjigje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave duhet të ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave është në proporcion me kuotat që zotëron secili prej ortakëve në këtë shoqëri. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 90 ditëve i ofrohen personave të treta jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhen me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakëve.

Të gjitha transferimet e kuotave kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve dhe në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Neni 12

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratorëve, si dhe emrat e Ortakëve duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të teta. Shoqëria ka vullën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Neni 13

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktuale dhe jashtë kontraktuale. Ortaku i shoqërisë drejton procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të teta pa asnjë kufizim.

Organet e shoqërisë janë:

1- Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.

2- Administratori.

Neni 14

A S A M B L E J A E O R T A K E V E

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo nga ortakët e percaktuar sipas nenit 84 të ligjit 9901. Anëtarët duhet të njoftohen jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar dhe në lajmërim duhet të jenë

shkruar vendi, ora dhe çështjet që do të trajtohen. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.

Neni 15

TE DREJTAT E ASAMBLESË

Asambleja e ortakeve ka kompetencat e mëposhtme:

- Ka të drejtë të beje ndryshime në statut në rast kur janë dakord ortakët që përfaqësojnë tre të katërtat e kapitalit themeltar.
- Ka të drejtë të miratojë bilancin e shoqërisë dhe të beje ndarjen e fitimit.
- Ajo emëron administratorët, zëvendësin, ekspertet dhe revizoret kontabël.
- Ajo ka të drejtë të beje përjashtimin e një ortaku nga shoqëria për rastet e parashikuara në ligj si dhe në rregulloren e brendshme të shoqërisë.
- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencë të Asamblesë.
- Përcakton shpërblimin për administratorët, ekspertet, revizoret kontabël.
- Ben transferimin e kuotave të të tretet.
- Ben lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender, ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të paluajtshme të shoqërisë etj.
- Ka të drejtë të beje modifikimin e kontratës së shoqërisë.

Neni 16

- Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
- Asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 17

Kur pjesëmarrja në asamble është normale vendimet që merren brenda kufijve të kontratës së themelimit, Statutit e të ligjeve janë të detyrueshme për të gjithë, edhe për ata që nuk kanë diskutuar edhe për ata që nuk janë dakord.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër që nuk është administrator. Asnjë i dërguar nuk mund të përfaqësojë më shumë se një ortak.

Në Asamblenë e Ortakeve marrin pjesë nëse është e nevojshme për të dhënë mendim pa të

drejte vote eksperte, revizore etj.

Neni 18

Asambleja merr vendime te vlefshme ne rastet e parashikuara me poshtë:

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 tënenit 88 të ligjit 9901.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

b) Për ndryshimet ne Statut, zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë merr vendime te vlefshme me tri të katertat e votave te orakeve pjesmarres, siç percaktohet ne piken 1, te nenit 86 te ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite Tregetare".

Neni 19

Marrja e vendimeve te Asamblesë, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentet e tjera qe kane te bëjnë me te duhet te bëhen sipas legjislacionit ne fuqi për këtë qellim.

Neni 20

ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili caktohet ne statutin e shoqërisë dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori/et qëndrojnë ne detyre për një periudhe kohore prej 5 vjet dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e secilit prej tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit përkatës duke treguar me fakte demin qe i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tij pasi eshte dhënë mendimi per kete dem edhe nga specialistet përkatës.

Ata kane te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqërisë dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me përjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqërisë u'a jep shprehimisht ortakeve.

Administratori/et kane te drejte qe te gjitha kompetencat e përmendura me sipër t'i ushtrojnë se bashku apo vec e vec duke qene pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë apo te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

Ata nuk mund te marrin vendime te rëndësishme siç janë huatë, te shesin pronat e shoqërisë, apo te bëhen dorëzanes ne emer te saj. Ata nuk mund te kryejne veprime te cilat i lihen ne kompetence Asamblesë se Ortakeve.



Asambleja mund të vendosë lejimin e një shpërblimi në favor të Administratorit për kryerjen e detyrës përveç pagimit të shpenzimeve.

Administrator i shoqërisë është z. Ardian Mullaj.

Neni 21

Administratori mund të emërojë një ose më shumë administratore të deleguar ose përfaqësues të thjeshtë për të kryer veprime të veçanta duke përcaktuar fuqinë e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin dhe ligjet në fuqi dhe vendos dhënien e një shpërblimi në favor të tij. Detyrat e tyre do të përcaktohen në një rregullore të brendshme të shoqërisë.

Neni 22

Administratori/ët kanë liri të plote për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejnë të gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe në Statut që i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Neni 23

Administratori/ët kanë të drejtë të nënshkruajnë për kapitalin e shoqërisë, kontrata të ndryshme, për furnizime publike private, të ndërmarrin veprime gjyqësore për dhe në emër të shoqërisë, etj. Administratori mund të japin prokurë në kufijtë që i lejon Asambleja e Ortakëve për kategori të caktuara veprimesh.

Administratori/ët janë të detyruar të mbajnë regjistrat e magazinimit të cilat vihen në dispozicion të organeve kompetente për të mundësuar kryerjen e kontrolleve prej saj. Administratoret e shoqërisë janë të detyruar të mbajnë inventar të rregullta një herë në muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore, hartohen nga Administratoret.

Neni 24

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për demet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 25

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETTIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretet e të gjitha akteve dhe dokumenteve që janë përcaktuar si të tilla nga administratoret e kësaj shoqërie.

Neni 26

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABËL

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e

shoqërisë i besohet nje eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do te qëndroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 27

BILANCI DHE FITIMET

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

Neni 28

Ne rast se kapitali i shoqërisë per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve për mundësinë e prishjes se shoqërisë.

Neni 29

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Ne rast se shoqëria prishet per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron nje ose me teper likuidator dhe përgatit te gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

Neni 30

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Për sa është shprehur ne këtë statut i referohemi Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqërisë. Çdo ndryshim behet ne te njëjtën mënyre siç është nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kësaj shoqërie.

Ky statut nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë ne Sarande, **sot me date 03.09.2025**

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "AREN KONSTRUKSION" SH.P.K.

Ardian Mullaj Ardian Mullaj 

Arben Hamiti Arben Hamiti 